

## PROGRAMI I TRANSPARENCËS PËR GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR FIER

### I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"(LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik (këtej e tutje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. AP-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj. Gjithashtu për shkak të strukturës dhe menuve të limituara të faqes zyrtare Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në pamundësi teknike, të publikimit të plotë dhe në formë të organizuar të informacionit në përputhje të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", me kërkesë të publikut vendose në dispozicion të tij sipas rastit çdo informacion apo dokument duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Tekstet e vendimeve gjyqësore publikohen në formë të anonimizuar në zbatim ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

### II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë:

1. "E drejta për informim" është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe përkatësisht: Ligji Nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren "Për Marrëdhënien e Gjykatës me Publikun" miratuar me Urdhrin Nr. 6777/5 datë 30.09.2010.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (këtej e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;

- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

### **III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË**

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Në përputhje me këtë program transparence të miratuara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier vendos në dispozicion të publikuara në faqen e tij të internetit [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

#### **Strukturën organizative të autoritetit publik;**

Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për kopje të kërkesave të regjistrimeve audio, si dhe procedurat të heqjen e akteve përkatëse;

Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit;

Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përkrahje të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifrat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përkrahjen e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme; Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përkrahje të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;

Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier një përkrahje të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve,

formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë; Tekstet e vendimeve gjyqësore publikohen në formë të anonimizuar në zbatim ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

#### TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR FIER

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Skemë Tabelë e funksioneve, detyrave dhe kompetencave të drejtuesve/gjyqtarëve, arsimit, kualifikimet e drejtuesve Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë	Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare Menjëherë pas miratimit të aktit nga titullari.	Në faqen zyrtare në menunë: “Struktura e Gjykatës” Në faqen zyrtare në menunë: “Publikime”, “Pasqyra e shtypit” dhe Rregullore të gjykatës”	Administrata e Gjykatës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
		Rregulloren “Për Marrëdhënien e Gjykatës me Publikun” miratuar me Urdhrin Nr. 6777/5 datë 30.09.2010 CV-të e gjyqtarëve dhe lista e emrave të stafit të Gjykatës Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kontaktet zyrtare		“Programi i Transparencës” në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier	
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Vendim nr. 238/1/a datë 24.12.2008 Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore Rregullore “Mbi përdorimin e internetit, aksesin dhe	Pas hyrjes në fuqi Pas miratimit të titullarit	Në faqen zyrtare në menunë: “Publikime dhe pasqyra e shtypit” “Programi i Transparencës” në	Ministria e Drejtësisë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier KLGJ

mirëmbajtjen e paisjeve të teknologjisë së informacionit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier" Kodi etik i administratës gjyqësore Rregullore e disiplinës në punë Rregullore për marrëdhënien e gjykatës me publikun Rregullore e menaxhimit të shpenzimeve për njoftime Rregullore e përshkrimit të detyrave Rregullore për vleresimin e punës së stafit administrativ të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier Rregullore për furnizimin e brendshëm me material konsumi dhe inventari Rregullore e brendshme e manaxhimit të arkivit Rregullore për orarin e punës të pushimit dhe gadishmërisë Rregullore e përdorimit dhe administrimit të automjetit Rregullore garantimit të rregullit dhe sigurisë në gjykatë Rregulloren për shfrytëzimin, mirëmbajtjen, riparimin, lëvizjen, ruajtjen dhe inventarizimin e materialeve

hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier Në faqen zyrtare të KLGJ në linkun <http://www.klgj.al>

Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe informacion mbi ndryshimin e orarit

Neni 7/1/c/g

Format kërkesë për Informacion në faqes zyrtare

Rregullore e brendshme e Kryetarit së Gjykatës Fier "Rregullore e Brendshme e Menaxhimit te Arkivit Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Fier" Format kërkesë/Format ankese Adresë postare: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Lagjja: "29 Nëntori"; Rruga: "Todi Shkurta"; Fier-Albania Kodi Postar 9301

Pas miratimit të titullarit të Programit të transparencës. Menjëherë, në rast ndryshimesh

Në faqen zyrtare në menunë përkatëse " në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier

Administrata e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier

të shërbimit me publikun		Email: Gjykata.Fier@gjykata.gov.al ose Klodiana.Malaj@gjykata.gov.al Adresë web:www.gjykata.gov.al Koordinatori për të drejtën e informimit i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier Zj.Stela Fili Email:Stela.Fili@gjykata.gov.al Adresa: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Lagjja: "29 Nëntori"; Rruga: "Todi Shkurta"; Fier-Albania Orari: E Hënë-E Premte 08:00 - 16:00			
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç		Pas miratimit të urdhrit të caktimit të Koordinatorit	Programi i transparencës” rubrika “Kordinatori për të drejtat e informimit” www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier do të publikohet.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Përshkrim i procedurave të kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	Ligj Nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë; Ligji Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	Pas hyrjes në fuqi	Pas botimit në Fletoren zyrtare.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Mekanizmat monitorues; raporte auditit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1/dh	Analiza Vjetore e Punës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier 2015 Analiza Vjetore e Punës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier 2017 Analiza Vjetore e Punës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier 2021 Rezultatet e sondazheve të realizuara nga gjykata sipas formularëve të CEPEJ Ligji për buxhetin dhe akte nënligjore në zbatim të tij Udhëzim Nr. 7/1 , Datë 28.02.2014 "Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor" Udhëzim Nr. 2 Datë 06.02.2012 “Për Proçedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” Raporti përfundimtar i Auditit të brendshëm për vitin 2021 Analiza financiare për vitin 2021	Përditësohet dhe publikohet periodikisht	www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier do të publikohet. Në menunë “Publikime” dhe “Pasqyra e shtypit”	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Buxheti	Neni 7/1/e		Pas hyrjes në fuqi	Në faqen zyrtare të KLGJ-së www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier do të publikohet.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier Zyra e Buxhetit

Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Regjistri/lista e kontratave të lidhura për vitit 2021 Regjistri/lista e kontratave të lidhura për vitin 2021 VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit publik”, Udhëzimi Nr.2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të prokurimit publik” Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”(i ndryshuar)	Menjëherë pas dërgimit në APP.	Në faqen zyrtare të APP Në faqen zyrtare te www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Fier do të publikohet në menunë: “Publikime” dhe “Pasqyra e shtypit”	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier Zyra e Buxhetit
Shërbimet e autoritetit për publikun.	Neni 7/1/f	shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, Shërbimit Përmbarimor, Noterisë Vërtetime, Ankime, Rekurse, Kopje aktesh/dokumentash Kërkesë-padi,Vendime etj. Në përputhje me kërkesat ligjore Projekt akte ligjore dhe nënligjore. Njoftimi Elektronik i Akteve	Përditësohet  Pas botimit në Fletoren zyrtare.	Në faqen zyrtare në menunë:“Publikime” dhe “Pasqyra e shtypit”	Kryesekretaria Punonjësi i (IT)
Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	Gjyqesore urdheri nr.360 datë 05.09.2013 Urdhër "Për miratimin e objektiva të brendshëm të gjykatë, për menaxhimin më të mirë të kohës në gjykimin e çështjeve gjyqësore Urdhër mbi mbarëvajtjen e procesit të mbartjes së dosjeve dhe hartimin e statistikave vjetore	Përditësohet menjëherë  Pas miratimit të ligjit apo të projektit.	Në faqen zyrtare www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit GjyqësorëFier.	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier
Mbajtja e dokumentacionit nga Gjykata e	Neni 7/1/h	Urdhër Nr.4895/5 datë 01.11.2016 Rregullore mbi metodiken dhe	Përditësohet Pas botimit në Fletoren zyrtare.	Në faqen zyrtare në menunë: “Publikime” dhe “Pasqyra e shtypit”	Arkivi Protokolli

Rrethit Gjyqësor Fier		tipologjine e menaxhimit të arkives gjyqësore. Ruajtja e dokumentacionit në sistemin arkivor të institucionit bëhet në përputhje me kuadrin ligjor për arkivat në Republikën e Shqipërisë. Ligji. nr.9154, datë 06.11.2003. "Për arkivat". VKM nr. 903, Datë 17.12.2014 "Për krijimin e arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor"		
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligjit nr.119/2014.	Neni 7/1/i	Tabelë në format elektronik	Pas miratimit të programit të transparencës. Përditësohet elektronikisht	Në faqen zyrtare në menunë "Programi i transparencës" Me kufizime të identitetit të kërkuarit/ankuesit. Koordinatori për të drejtën e informimit
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Datat e gjyqësore të vendimeve gjyqësore të anonimizuar, planifikimet, informacion mbi shortin, kalendari i seancave etj. Regjistri Elektronik i Ekspertëve Lista e avokatëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti Lista e ekspertëve dhe vlerësuesve të dëmeve materiale dhe shëndetësore, miratuar nga Kancelarja e Gjykatës	Përditësohen elektronikisht në portalin e gjykatës	Në faqen zyrtare në menunë: "Çështje Gjyqësore" "Informacion mbi shortin", "Kalendari i Seancave" Administrata e Gjykatës Koordinatori për të drejtën e informimit
Informacione të tjera të dobishme	Neni 7/1/l	Lista e ekspertëve kontabël Lista e Ekspertëve të Ing. Gjeodet, Ndërtimi, Vlerësues Pasurive të Paluajtshme Lista e përditësuar administratorëve të falimentit Lista e përkthyesve të autorizuar përkthime në 26 gjuhë të ndryshme etj. Lista e ekspertëve psikologje etj. Lista e avokatëve kryesisht dhe grafiku i gadishmërisë	Përditësohen Periodikisht pas përpilimit nga kancelari Pas miratimit të institucionit përkatës Pas miratimit të Ministrisë të Drejtësisë	Në faqen zyrtare në menunë: "Publikime" dhe "Pasqyra e shtypit" Agjensia e Mbikqyrjes së falimentit Ministria e Drejtësisë

Broshura informuese dhe letra e  
të drejtave  
Lista e shërbimeve sociale Fier  
Lista e shërbimeve sociale Patos  
Lista e shërbimeve sociale  
Roskovec

## II.PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AP-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [[www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al)] dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## III.MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës sëinformimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.